



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SELENICË

**NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK**  
**Për projekt-vendimin: “Plani Integritetit, Bashkia Selenicë 2026–2028”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar; Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Selenicë, Bashkia Selenicë dhe Këshilli Bashkiak Selenicë njoftojnë hapjen e procesit të konsultimit publik për projekt-vendimin: **“Plani Integritetit, Bashkia Selenicë 2026–2028”**.

Ky dokument është dokument strategjik nepermjet te cilit institucioni zotohet per forcimin e integritetit dhe marrjen e masave per parandalimin e sjelljeve dhe veprimeve anti-integritet ne institucionin e Bashkisë Selenicë,

Procesi i konsultimit publik ka për qëllim marrjen e mendimeve, komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit dhe çdo palë tjetër e interesuar.

**Takimi publik konsultativ do të zhvillohet më:**

**Datë:** 15/ 07/ 2026

**Ora:** 11:00

**Vendi:** Ambientet e Bashkisë Selenicë

Projekt-dokumenti “Plani Integritetit, Bashkia Selenicë 2026–2028” do të jetë i disponueshëm për publikun në faqen zyrtare të Bashkisë Selenicë, në ambientet e Bashkisë, si dhe pranë sekretariatit të Këshillit Bashkiak.

Të gjithë të interesuarit ftohen të paraqesin mendimet, komentet dhe rekomandimet e tyre me shkrim, brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik, deri më datë 15/ 07/ 2026, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- me postë elektronike në adresën: **info@bashkiaselenice.gov.al**;
- pranë Protokollit të Bashkisë Selenicë;
- pranë Sekretariatit të Këshillit Bashkiak Selenicë;
- gjatë takimit publik konsultativ, ku komentet do të pasqyrohen në procesverbal.

Për informacione të mëtejshme dhe për administrimin e komenteve, person kontakti është:

## **Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**

Emër/Mbiemër: Bleona Haskaj

E-mail: [bleona.haskaj@bashkiaselenice.gov.al](mailto:bleona.haskaj@bashkiaselenice.gov.al)

Tel: 0675130475

Bashkia Selenicë dhe Këshilli Bashkiak Selenicë ftojnë të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit të marrin pjesë aktivisht në këtë proces, me qëllim që Plani i Integritetit të pasqyrojë sa më mirë risqet e integritetit në Bashkinë Selenicë.